

STATUTI
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“Smart Self Service” sh.p.k

Në Tiranë, sot më datë 04/09/2025 (dymijë e njëzetë e pese), midis:

- 1- Orbit shpk, me numer NIPT-i M12220005C, me seli ne adresen: Njesia Administrative Nr. 9, Rruga Karl Gega, Zona Kadastrale 8340, kati pare, Tirane, e perfaqesuar ligjerisht nga Z. Edmond Liçaj, shtetas shqiptar, i biri i Mexhit, lindur me 01/06/1989 në Peshkopi, banues në Tiranë, nr. personal I90601002F, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zoteron 100% te aksioneve dhe eshte administrator i kompanise.
- 2- Paragon shpk, me numer NIPT-i M22211029E, me seli ne adresen: Rruga Tre vellezërit Kondi, Tirane, e perfaqesuar ligjerisht nga Z. Klodjan Bregu, shtetas shqiptar, i biri i Veip, lindur me 30/03/1981 në Skrapar, banues në Tiranë, nr. personal I10330074T, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zoteron 100% te aksioneve dhe eshte administrator i kompanise.

Në vijim referuar së bashku si **“Ortakët”**.

Pala e sipërcituara përpilon këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklaron me vullnetin e tij të lirë, të plotë dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, me ligjin 9901 datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me ligjin 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, me atë të ligjit Doganor, Fiskal e Tatimor, dhe Autoritetit përkatës sipas objektit të shoqërisë, se krijon Shoqërinë Tregtare të Kufizuar, **“Smart Self Service sh. p. k.**

KREU I

Neni 1
Krijimi

1. Sot me date 04/09/2025, ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin: **“Smart Self Service” sh.p.k.**
2. Themeluesit e shoqerise jane: Orbit shpk dhe Paragon shpk, te cilet kane themeluar shoqerine **“Smart Self Service” sh.p.k.**

Neni 2
Personaliteti Juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“Smart Self Service” sh.p.k** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Ortakët të cilët secili në veçanti gëzojnë kuotat e tyre në shoqëri, në përpjestim me kontributin e dhënë në kapital. Kontributi i Ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortakët e shoqërisë mbulojnë



personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, në rastin kur i kanë shlyer të gjitha kontributet e tyre.

Neni 3

Selia

Shoqëria do ta kete selinë në Tiranë, Shqipëri, me adresë: Rruga:Thoma Koxhaj, Yzberisht, Tirane. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e Ortakeve.

Neni 4

Objekti i Veprimtarisë

Shitje me makineri automatike. Magazinim te produkteve ushqimore. Perpunim, prodhim, ambalazhim, paketim si dhe tregti me pakice dhe shumice te produkteve ushqimore. Import-eksport te tekstileve dhe nenprodukteve te tyre ne Republiken e Shqiperise, Import-eksport i materialeve te ndertimit, pajisjeve elektrike dhe elektronike, etj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqind mije) ALL, i ndarë në 2 kuota, ku ortaket zotërojnë kuotat e mëposhtme të kapitalit të Shoqërisë:

- 1- Ortaku Orbit shpk, me numer NIPT-i M12220005C, zoteron 1 kuote ne masen 50% te kapitalit themeltar me vlere 50.000 (pesedhjte mije) leke.
- 2- Ortaku Paragon shpk, me numer NIPT-i M22211029E, zoteron 1 kuote ne masen 50% te kapitalit themeltar me vlere 50.000 (pesedhjte mije) leke.

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.



Neni 7
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 8
Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 9
Organi Vendimmarrës

Organet Vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- 1- Asambleja e Përgjithshme;
- 2- Administratori.

Shoqëria ka të drejtë që në të ardhmen të shtojë organet e saj, siç mund të jetë Këshilli Administrativ.



Neni 10
Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e
- g) pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- h) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- i) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- j) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- l) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- n) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 11
Administrimi

Administrator i shoqërisë është Z. Julian Hoxha, i biri i Tefik, lindur më 08.11.1989, në Berat, banues në Tiranë, nr. personal I91108001B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në rastet kur: sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shakllëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidare sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1.a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut të vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administrator vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë



realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet e shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është i ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e Ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të ushtruara të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë Ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 15

Shpërndarja ose Prishja e Shoqërisë

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;



Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë, emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 16

Likuiduesi

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat dhe detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundër drejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së Ortakëve dhe administratorit.

Neni 17

Të drejtat dhe detyrimet e Likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.



Neni 18
Përfundimi i Likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon ç'regjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 19
Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqërie tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijimin e një shoqërie të re.

Neni 20
Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:
 - a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
 - b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
 - c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.



Neni 21
Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 22
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 23
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24
Dispozitat Përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm u miratua në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të **shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Smart Self Service”**, dhe nënshkruhet nga të gjithë Ortakët themelues në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKET

Per Orbit shpk

Administratori

Edmond Liçaj



Per Paragon shpk

Administratori

Klodjan Bregu

